

**DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME
TË KOSOVËS PËR
ÇËSHTJE QË LIDHEN
ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
PRIVATIZIMIT**

**SPECIAL CHAMBER OF
THE SUPREME COURT
OF KOSOVO ON
PRIVATIZATION AGENCY
OF KOSOVO RELATED
MATTERS**

**SPECIJALNA
KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODOSE NA
KOSOVSKU
AGENCIJU ZA
PRIVATIZACIJU**

AC-II-12-0139

Në padinë e

Paditësi/Ankuesi

1. H.S. XX

Kundër

E paditura

1. E "U.C.", Hereq, të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr."Ilir Konushefci" nr. 8 , Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DhPGjS), në përbërje të Mr.sc. Sahit Sylejmani, si Gjyqtar kryesues, Merja Halme-Korhonen, Cornelis Van Der Weide, David Wilcox dhe Sabri Halili gjyqtarë, në apelin e paditësit të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë C.nr 337/2007, të datës 10.08.2010 , pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 30 prill 2013 lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit e paraqitur ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjakove C.nr. 337/2007 të datës 10.08.2012 hedhet poshtë si e papranueshme.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me datë 08 shkurt 2007, paditësi dorëzoi në DHPGJS një padi dhe kërkoi nga DHPGJS-ja që ta detyron Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit t'i ndërpres procedurat e shitjes së paluajtshmërive, duke mos i cekur asnjë ngastër konkrete kadastrale, por si kompleks i ngastrave i cili gjendet në anën e majtë në aksin rrugor f. Rastavicë - Junik dhe aksin rrugorë f. Rastavicë - Gjakovë në anën e majtë të kësaj rruge. Paditësi deklaron se i përfaqëson 73 pronarë të paluajtshmërive, pronat e të cilëve u janë nacionalizuar dhe të cila janë evidentuar dhe shfrytëzuar pa kurrfarë kompensimi nga e paditura gjerë në vitin 1999, ndërsa pas këtij viti këto ngastra shfrytëzohen nga vetë pronarët.

Paditësi kërkon si masë të përkohshme, ndërprerjen e shitjes së patundshmërive të sipër shkruara.

Më 24 prill 2007, Trupi Gjykes i DHPGJS-së me Aktvendimin SCC-07-0060, kërkesën e paditësit lidhur me masë të përkohshme e hedhë si të papranueshme, ndërsa padinë e përcjellë në Gjykatën Komunale në Gjakovë, dhe udhëzon se në rast se ka ankesë ndaj aktvendimit të kësaj Gjykate, ajo duhet të depozitohet në DHPGJS.

Më 10 gusht 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë me Aktvendimin C.nr 337/2007, padinë e paditësit e ka hedhur poshtë si i pa objekt kontesti.

Gjykata në aktvendimin e ankimuar thekson se pas studimit të shkresave të lëndës është arritur në përfundim se paditësi në padinë e tij ka parashtruar

të vetmen kërkesë, ndërprerjen e shitjes së patundshmërive, pa numra të ngastrave kadastrale, pa një kërkesë tjetër kryesore si: vërtetimi i së drejtës së pronësisë apo dorëzimi në posedim të paluajtshmërisë "lëndore", dhe nga kjo vjen në përfundim se nuk ka objekt kontesti, se për çfarë duhet të vendosë.

Më 27 shtator 2010, paditësi(në tekstin e mëtejme ankuesi), paraqet ankesë vetëm në gjuhën shqipe ndaj aktvendimit të cekur të Gjykatës Komonale për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Për më tepër ankuesi konsideron se janë shkelur dispozitat e nenit 12.1 pika (a) dhe (c) lidhur me nenin 13.2 pika (iii) të UA të UNMIK-ut 2008/6, pretendohet se aktvendimi i ankimuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe arsyet e aktvendimit. Ky aktvendim nuk ka fare arsye apo për të nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare , ose ato janë të paqarta dhe kontradiktore. Gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë sipas paditësit dhe është vendosur në mënyrë të kundërligjshme pa pas bazë juridike që të hidhet padia si i pa objekt kontesti.

Më 05 tetor 2010, paditësi dorëzon një parashtresë në DHPGJS, të cilës ia bashkangjet ankesën e përkthyer në gjuhën angleze.

Më 03 maj 2012, Kolegji i Specializuar për çështje pronësore i DHPGJS-së, me urdhër të brendshëm lëndën SCA-10-0071, e urdhëron Zyrën e regjistrimit ta regjistrojë si lëndë për Kolegjin e Apelit, dhe ankesa e paraqitur merr numrin AC-II-12-0139.

Më 22 maj 2012, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së kërkon nga ankuesi që të deklarohej se me cilën datë i është dorëzuar aktvendimi i ankimuar dhe të dorëzon kopjen e këtij aktvendimi si dhe nga ai është kërkuar që ta dorëzon përkthimin e aktvendimit të ankimuar në gjuhën angleze, ose në bazë të

nenit 25.9 të Shtojcës së LDHP-së, të paraqesë në ankesë Kryesuesit të Kolegjit të Apelit për ndihmë në përkthim të parashtresave. Në Urdhër është paralajmëruar për pasojat procedurale që mund të lindin për ankesën, në rast se nuk plotësohen kërkesat e urdhërit.

Ankuesi urdhrin e ka pranuar me datë 28 maj 2012, ndërsa nuk i është përgjigjur asnjë kërkesë të shprehur në urdhër.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Ankesave

Ankesa është e papranueshme. Bazuar në nenin 64.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë e Privatizimit (këtu e tutje: Shtojca), Kolegji i Apelit vendosi që të mos e mbajë pjesën gojore të procedurës.

Ankuesi nuk i është përmbajtur urdhrin të datës 22 maj 2012, pasi që nuk e ka dërguar kopjen e Aktvendimit të ankimuar dhe një parashtresë për të saktësuar datën e pranimit të tij e gjithashtu nuk është dërguar as përkthimi në gjuhën angleze i aktvendimit të ankimuar dhe as nuk është bërë kërkesë për ndihmë në përkthim.

Ratio legis (d.m.th. qëllimi) i Nenit 60.1 (nënpika 4 dhe 6) i Shtojcës së LDHP-së është që t'ia mundësojë Kolegjit të Apelit që ti shqyrtojë kriteret e pranueshmërisë së një ankese në shikim të parë, pa pasur nevojë që ta kërkojë dosjen e lëndës nga gjykata e shkallës së parë dhe që të qartësojë se ankuesi faktikisht është duke e ankimuar vendimin e duhur dhe se ankesa është paraqitur me kohë. Andaj, dispozita nuk është vetëm një barrë procedurale e pakuptimtë, por ajo e ka vendin e vet brenda kriterëve të pranueshmërisë së një ankese (shih, *ex multis*, ASC-09-0065).

Pasi që ankuesi nuk i është përmbajtur urdhrin, ankesa nuk i përmbush

kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara në nenin 60. 1 nënpika 1.4 dhe 1.6 dhe nenit 28.2 (6), lidhur me nenin 58.2 të Shtojcës së LDHP.

Për arsyet e mësipërme, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore / Shpenzimet:

Gjykata nuk i cakton shpenzimet për ankuesit pasi që Presidiumi deri me tani nuk ka lëshuar një plan me shkrim të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (neni 57.2 i Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-033) mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje të Lidhura me Agjencinë e Privatizimit të Kosovës). Kjo do të thotë se deri tani nuk ka asnjë bazë ligjore për vënien e shpenzimeve.

U vendos nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së më 30 prill 2013:

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues,

URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIT:

Ju lutem ta dërgoni këtë aktvendim te:

1. Paditësi/ankuesi (duke përfshirë përkthimin e tij në gjuhën angleze).
2. Te e paditura (duke përfshirë përkthimin e tij në gjuhën angleze).
3. Gjykata Komunale në Gjakovë, C.nr 337/2007

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues,

[nënshkruar]